

Kumtesë e mbajtur në konferencën e organizuar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë në nderim të shkrimtarit Ismail Kadaresë me rast të 80-vjetorit të tij të lindjes (Tiranë 2016)

Pasojat e përkohëshme të „grindjes letrare gjermano-gjermane“ për receptimin e veprës së Ismail Kadaresë në gjuhën gjermane

Çdo vepër letrare që përkthehet për t'u botuar jashtë vendit të origjinës duhet të riprovohet vlerën e vet në ambientin e huaj, duke u ballafaquar me ndryshimet kulturore, me mentalitetin, shijet dhe përvojat e publikut letrar atje, por edhe me diskutet estetike ose politike që mund të ndikojnë mjaft në suksesin ose mosesuksin e librit në tregun edhe të kritikës letrare.

Një gjë e tillë vërehet edhe në fatin që kishin librat e Kadaresë në botën gjermanishtfolëse.

Atje, d.m.th. në Gjermani, Austri dhe Zvicër, botimi sistematik i veprës prosaike të Kadaresë kishte filluar në pjesën e dytë të viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, dhe romane si „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“, „Kronikë në gur“ ose „Kamarja e turpit“ patën një jehonë shumë pozitive, nganjëherë entuziaste, të publikut si të kritikës letrare.

Pastaj, brenda një kohe shumë të shkurtër, në fillim të viteve nentëdhjetë, ishte për t'u regjistruar një ndryshim rrënjesor klimë: Në disa gazeta të rëndësishme gjermane dolën recensionet nganjëherë gati asgjësuese për librat dhe autorin, dhe kritikën më të ashpër vinin nga ata recensionistë që sapo kishin lavdëruar romanet dhe talentin e autorit.

Si shpjegohet ky fenomen i çuditshëm? Çfarë kishte ndodhur?

Pas rënies së Murit të Berlinit në vitin 1989 dhe ribashkimit të të dy shteteve gjermane në vitin 1990, në rrethet letrare gjermane shpërtheu një debat i ashpër për vlerën ose mosvlerën të krijimtarisë letrare në Republikën Demokratike të Gjermanisë, nën kushtet shtrëngimeve të krijuara nga regjimi komunist. Ky debat hyri në historinë letrare gjermane me emërtimin disi të habitshëm „grindja letrare gjermano-gjermane“. Duhet të kemi parasysh se Gjermania ishte i vetmi vend demokratik perëndimor, ku shembja e diktaturave komuniste dhe ballafaqimi me trashëgiminë e hidhur të tyre ishte një problem i brëndshëm, ndryshe p.sh. nga Franca, Britania e Madhe, Italia ose Shtetet e Bashkuara ku njerëzit më shumë ishin shikues të jashtëm të zhvillimeve përmbysese në vendet ish-socialiste. Kjo gjë mund të shpjegohet ndezjen e tepërt të gjakrave dhe qëndrimin e ashpër dhe shpeshherë të padrejtë ndaj shkrimtarëve që kishin qenë të ngarkuar me barrën të jetonit nën një regjim komunist.

Polemika filloi në vitin 1990 me sulmet e disa gazetarëve të shtypit konservator gjerman mbi autoren gjermano-lindore me fam botëror dhe kandidaten për çmimin nobel, Christa Wolf. Ajo sapo kishte botuar një version të ripunuar të një tregimi të vitit 1979, me titullin "Ç'mbetet", me reflektime të autores për jetën e saj në diktaturë. Gjyqtarët e saj të vetëmëruar, gazetarë dhe kritikë letrar, e qortuan shkrimtaren për faktin se e kishte publikuar tregimin kaqvonë, vetëm pas rënies së diktaturës, dhe jo në formë origjinale por me ripunime, duke hamendësuar se në kohën e duhur, domethënë dhjetë vite më parë, s'kishte pasur guximin të hynte në konfrontim me regjimin komunist. Gjithashtu e kritikuan se nuk kishte demonstruar hapur pakenaqësinë e saj me shtetin gjermano-lindor, duke e lëshuar në shenjë proteste si disa të tjerë, por, sipas tyre, kishte afirmuar dhe madje forcuar regjimin me praninë dhe bile bashkëpunimin e saj. Këtu ndoshta vlen një shpjegim: Në krahasim me Shqipërinë, ku krijuesit devijues ose disidentë përfunduan në burg ose drejtëpërdrejtë në varr, shteti gjermanolindor mbante një qëndrim më liberal me „diversantët“ kulturor, duke ua hequr shtetësinë dhe duke i shtrënguar të lëshonin vendin për t'u shpërngulur në perëndim, bashkë me familjet e tyre.

Në fazën e dytë të „grindjes“ armata sulmues zgjëroi frontin e luftës, duke përfshirë tani të gjithë shkrimtarët jo vetëm në Gjermani lindore por në gjithë kampin e atëhershëm socialist që nuk kishin zgjedhur rrugën e mërgimit, duke vënë në dyshim në menyrë tërësore vlerat estetike të krijimtarisë letrare të tyre. Dhe me në fund, në fazën e tretë, u kërkua jo vetëm rishikimi dhe rivlerësimi i letërsisë gjermanolindore, por edhe i letërsisë gjermanoperëndimore pas luftës së dytë botërore, e cila gjoja kishte rënë nën ndikimin e prirjeve të majtë (ç'do të thotë socialdemokratike) në politikë dhe shoqëri, duke u pajtuar ose paqësuar me rrezikun që vinte nga lindja. Në shënjestër të kritikës ishin sidomos pjesmarrësit e të famshmit "grupit 47", pra Heinrich Böll, Günter Grass, Hans Magnus Enzensberger e të tjerë, që nën traumën e holokaustit ishin përpjekur të etablonin një letërsie të re demokratike, humanitare në Gjermani, të çliruar nga nacionalizmi i sëmurë i diktaturës hitleriane. Përpjekjet e tyre nuk kishin mbetur pa sukses, por tani u akuzuan nga kritikët e tyre në kampin konservator se gjoja kishin mbivleftësuar nacional-socializmin duke nënvleftësuar ose bile zbukuruar komunizmin. Vlerat estetike e veprimtarisë së tyre u vunë në dyshim me argumentin se kjo veprimtari gjoja kishte qenë e drejtuar kryesisht nga motive shoqërore, morale, politike, ndërgjegjeje etj. Sa u përket mangësive të supozuar estetike në krijimtarinë e tyre, vlen të përmendet se Böll kishte fituar çmimin nobel për letërsi që në vitin 1972, ndërsa Grass do të ishte laureati i vitit 1999.

"Grindja letrare" në fakt ishte vazhdimi i një "grindjeje" tjetër në skenën intelektuale në Gjermani perëndimore, të quajtur "grindja e historianëve", që ishte zhvilluar në mes të viteve tetëdhjetë. Në qëndër të polemikave të ashpra kishin qenë tezat e historianit Ernst Nolte, i cili kishte mbrojtur pikëpamjen se në Gjermani në menyrë të njëanshme dënoheshin krimet e nazizmit, ndërsa krimeve e komunizmit nuk jepej rëndësia e duhur. Shkoi kaq larg të pretendonte që sipas shumë gjasave Hitleri kishte urdhëruar holokaustin vetëm nën presionin e rrezikut „aziatik“ komunist, duke kopjuar në të njëjtën kohë metodat staliniste të shfarrosjes në masë. Ky kendveshtrim ngjalli reagime të forta kundërshtuese te

shumica dërrmuese e historianëve jo vetëm në Gjermani. U theksua që nuk është e lejueshme të bëhen dallime cilësore midis sistemeve të ndryshme totalitare terroriste.

Në të dy „grindjet“, polemikat dhe kundërpolemikat vazhdonin për një farë kohe, përpara se të shuheshin pa pasur ndonjë fitues të qartë. Nga distanca e kohës ndoshta lejohet konkluzioni se të dy debatet pasqyronin përpjekjet e konservativizmit intelektual gjerman për të rforcuar pozitën e vet, e cila pas luftës se dytë botërore kishte pësuar një dobësim të ndjeshëm, për shkak të qëndrimit të lëkundshëm që disa nga rrymat konservatore politike në Gjermani kishin mbajtur para dhe pas rrëmbimit të pushtetit nga ana e regjimit nazist.

Pra, „grindja letrare gjermano-gjermane“ mbaroi pa rezultat të qartë, por jo pa pasoja dhe pa viktima. Midis këtyre viktimave ishte edhe shkrimtari shqiptar Ismail Kadare.

Pas vitit nëntëdhjetë, u dobësua dhe u shua toni dashamirës dhe shpeshherë adhurues në recensionet e librave të Kadaresë në shtypin gjerman, duke u zëvendësuar me një ton mjaft kritik dhe herë pas here armiqësor e bile fyes. Disa gazeta nuk i përmendnin më fare librat e sapobotuar dhe autorin e tyre. Botuesi i atëhershëm austriak u infektua nga dyshimi dhe pasiguria. Ishte ky ndryshim klime që, bashkë me disa faktore të tjera, shkaktoi një ndërpreje disa vjeçare të botimeve në gjuhën gjermane.

Shumica e argumenteve që përdorshin nga kundërshtarët e Kadaresë në shtypin gjerman ishin marrë hua nga diskutimet rreth veprës dhe personit të Christa Wolf. E qortuan Kadarenë sepse, sipas tyre, s’kishte përdorur autoritetin e tij si shkrimtar me fam botëror, për të kritikuar me zë të lartë regjimin komunist, se s’ishte larguar nga Shqipëria shumë më herët, për të vënë një sinjal, se disa nga veprat e tij nuk ishin botuar gjatë kohës së komunizmit ose vetëm me shkurtime. Censurën e egër nuk e përmendnin. Të gjitha këto mjaftonin për të cilësuar autorin si “njeri i afërt me sistemin” ose bile “bashkëpunëtor të regjimit”.

Mua më duket e nevojshme të përmend faktin se kundërshtarët e Kadaresë në gazetën gjermanishtfolëse, qoftë ata që me ndryshimin e konjunkturave ishin konvertuar nga të majtë në të djathtë, qoftë ata që kishin mbrojtur pozita konservatore që përpara, kishin kaluar gjithë jetën e tyre në kushtet e një sistemi tolerant demokratik dhe nuk kishin për të mbajtur mbi trup barrën e një regjimi totalitar. Pranoj që nuk më duket shumë morale të gjykosh për njerëz që kanë për të mbajtur këtë barrë në çdo ditë të jetës së tyre, kur vetë punon në ambientin e sigurt dhe të rehatshëm të një zyre redaksie në perëndimin demokratik. Të paktën do të ishte mirë të merrje parasysh fjalën e nobelistit Imre Kertesz, i cili gjatë jetës së tij ishte viktimë e dy sistemeve diktatoriale: *„... kur njeriu edhe në kushtet e totalitarizmit synon të mbijetojë, atëherë kontribuon me këtë veti në ruajtjen e totalitarizmit: kjo është një dredhi e thjeshtë organizimi.“*¹

Dukshëmrisht kritikuesit e Kadaresë në Gjermani s’kishin ndonjë ide të qartë për rrethanat e jetës dhe të krijimit në diktaturën e egër të Enver Hoxhas. Me sa duket, e barazonin me regjimin relativisht të moderuar në Gjermani lindore.

¹ Imre Kertesz: Ditari i galerës

Në atmosferën që u krijua në atë kohë, kishte edhe zëra kundërshtuese, por jo aq shumë.

Kulmin e sulmeve kundër Kadaresë në shtypin gjerman përbënte një recension në një nga gazetat me prestigjioze të Gjermanisë (Frankfurter Allgemeine Zeitung), i shkruar nga një nga ish-adhuresit të sipërpërmendur të veprës së Kadaresë, ku mes të tjerave u përmend edhe shprehja ose termi “diktatura Hoxha-Kadare”. Kjo fjalë monstroze ishte importuar drejtëpërdrejtë nga Shqipëria, ajo vinte nga rrathet e kundërshtarëve të përhershëm të Kadares atje. Unë nuk dua të përmend me emër njerëzit gjegjësisht njeriun që e ka sjellë në Gjermani. Por duhet të konstatohet se kundërshtarët e Kadaresë në Gjermani ishin nxitur dhe municionuar nga armiqtë të vjetër e të rinj të autorit të madh në Shqipëri, dhe jo pa dashje.

Gjithmonë e kam pasur të veshtirë të kuptoj motivet e grupit ose më mirë të grupeve të ndryshme të luftetarëve antikadarean, dhe sidomos egërsinë primitive të mësymjeve. Askush ka për detyrë t’i çmojë librat e Kadaresë, dhe asnjërit nuk mund t’i mohohet e drejta për të kritikuar autorin. Por kritika duhet të bazohet në arsyetim dhe jo në armiqësi personale ose zili, dhe duhet të zhvillohet në menyrë të qytetëruar, duke mos cënuar dinjitetin personal dhe profesional të të kritikuarit.

Fakt është që me fushatat e shëmtuara që arritën kulmin e tyre me rast të ndarjes së “Man Booker Prize”, kundërshtarët e Kadaresë dëmtojnë më shumë letërsinë shqiptare në terësi sesa Kadarenë; përveç kësaj njollosin edhe vetë Shqipërinë, duke ushqyer paragjykimet që ekzistojnë në botë për këtë vend.

Fakt është që prej kohësh Kadareja i ka bërë një shërbim të jashtëzakonshëm letërsisë shqiptare, duke luajtur rolin e akullthyesit, pa të cilin shkrimtarët e tjerë shqiptarë do ta kishin akoma më të veshtirë për të depërtuar në detin arktik të tregut botëror të letërsisë.

Përpiqem t’i dalloj pikat konkrete të kritikës në pellgun e turbullt të korit shumëzërësh. Shumë nuk gjej. E para pikë është e karakterit krejtësisht privat dhe mund të kishte ndoshur kudo në botë, me gjithë faktin e pashmangshëm që shërbimi sekret komunist kishte gishtat edhe në këtë lojë.

Mirëpo, si provë kryesore kundër të pandehurit Kadare zakonisht përdoret romani “Dimri i vetmisë së madhe”, i cili nga anti-kadareanët konsiderohet si punë dreqi sepse ndër protagonistët e librit gjendet edhe Enver Hoxha, diktatori.

Do të thoshja se askujt me aftësinë minimale gjykimi në fushën e letërsisë mund t’i vijë ndër mend të cilësojë romanin “Dimri i vetmisë së madhe” si një elozh për shefin e regjimit komunist. Ky roman artistikisht i arrirë prezanton një tablo tepër komplekse dhe të diferencuar të një shoqërie dhe një shteti në krizë, duke shmangur në menyrë konsekuente shabllonet dhe stereotipat e realizmit socialist.

Realizmi socialist propagandon në menyrë skematike idetë komuniste, duke i lidhur me një romantizëm aq patetik sa edhe bajat, por jo vetëm kaq: ai është mishërimi i këtyre ideve në fushën e estetikës. Flas për elementet përbërëse e një vepre prototipike të realizmit socialist: shtypjen e të ashtuquajtur “armiqve të klasës”, d.m.th. përligjen e poshtërimin të

një numri të madh njerëzish të pafajshëm, vetëm për shkak të origjinës familjare të tyre, mohimin e të drejtave individuale të njeriut, sidomos të fjalës së lirë, thjeshtëzimin deri në karikaturë të marrëdhënieve shoqërore, etablimin e urrejtjes si element baze i shoqërisë dhe politikës, justifikimin e një diktature të përgjakshme të një pjese të popullsisë mbi tjetrën (në teori) respektivisht të partisë mbi gjithë popullsinë (në praktikë), e të tjerë.

Në kushtet e një regjimi jashtëzakonisht të egër dhe shpirtlig komunist, siç ekzistonte në Shqipëri, Ismail Kadareja, në veprimtarinë e tij, ka treguar dhe zbatuar një mospërfillje absolute ndaj realizmit socialist, duke krijuar një vepër letrare me peshë botërore. Kjo është një meritë shumë e madhe. Prandaj unë e kam të veshtirë të kuptoj përmasën tmerruese të sulmeve kundër tij, ndërsa protagonistët kryesor të letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri kanë mbetur fare të paprekur, madje nderohen, dekorohen, dhe veprat e tyre prototipike socrealiste ruajnë vendin e tyre në fondin e letërsisë kombëtare, bile duke u konsideruar shpeshherë si xhevahire letrare.

Jam i vetëdijshëm se për arsye të ndryshme nuk kam të drejtën (dhe mund të shtoj: as dëshirën) të hyj në rolin e prokurorit në çështjen kundër letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Prapëseprapë dua të shpreh mendimin tim që, sa i përket trashëgimit letrar nga koha e diktaturës, duheshin, se pari, analiza të kujdesshme për të ndarë gurin nga egjra, në vend të elozheve respektivisht polemikave sipërfaqësore dhe të politizuara, dhe, se dyti: më duket absolutisht e nevojshme të hapen dosjet e Sigurimit (ose çfarë ka mbetur nga ato) siç e ka kërkuar Ismail Kadareja prej kohësh. Kjo për mua do të ishte një nga parakushtet për një vlerësim ose rivlerësim të drejtë të letërsisë shqiptare të pjesës së dytë të shekullit XX.

Christa Wolf, pasi ishte bërë objekt i sulmeve, publikoi fashikullin e plotë të "Stasi", d.m.th. të sigurimit shtetëror gjermano-lindor, për të, gjithsejt 42 dosje, duke ndihmuar në këtë mënyrë shumë në zbardhjen e çështjes dhe në shuarjen e mësymjeve kundër saj.

Sot, "grindja letrare gjermano-gjermane" i përket historisë, dhe gjithashtu "bojkotimi" i përkoheshëm i veprave të Kadaresë në botën gjermanishtfolëse, të rrjedhur prej saj.

Qysh prej vitit 2000, shtëpitë botuese prestigjioze "Ammann" (deri në mbylljen e saj) dhe pastaj "S. Fischer Verlag", kanë vazhduar botimin e librave të Kadaresë në gjuhën gjermane. Deri më tash publikut letrar gjermanishtfolës i është dhënë mundësia për t'u njohur me rreth dyzet romane, novela, tregime, ese dhe tekste publiciste të autorit të madh shqiptar, dhe aktualisht përgatiten kontratat për vepra të tjera që do të dalin në treg në vitet e ardhshme.

Joachim Röhm